

28925

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 28925/VENDIMI

V E N D I M

PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane sot me date 27.1.2003, une gjyqtare E. Zyrt ne gjykatën se shkalles se pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Kol GJELOSHI dhe dokumentat bashkengjitur kerkeses, me objekt regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ELVISI 03 " sh.p.k

K O N S T A T O V A

Kerkuesi Kol GJELOSHI , me kerkese drejtuar Gjyqates se shkalles se pare Tirane ka kerkuar regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ELVISI 03 " SH.P.K , me ortak te vetem dhe administrator Kol GJELOSHI , me kohezgjatje te aktivitetit mbi 10 vjet, me seli ne Fushe Kuqe Laç ,me kapital themeltar 100 000 leke, dhe me objekt te veprimtarise :

- Perpunim fraksionim inerte .
- Tregetin me shumice dhe me pakice , import eksport te artikujve / te ndryshem industrial, ushqimor, elektroshtepiake, konfeksione, kozmetike.
- Tregetim dhe shitje produktesh artizanati, kimike, tekstile, artikuj plastik, xhama mobilje.
- Tregetim produktesh te gateshme dhe gjysem te gateshme me shumice dhe me pakice.
- Tregetim te artikujve sportive dhe argetimi, materjale kancelarie , paisje zyresh etj. Aktivitete te ndryshme tregetare si hapje dyqane , bar bufe, hoteleri, restorante..
- Tregetim materjale ndertimi, paisje te ndryshme elektrike e me shumice dhe me pakice si dhe import eksportin e tyre.
- Investime ne ndertim e fusha te tjera .
- Transport ,import, eksport dhe tregetimin e produkteve bujqesore e blegtorale, fruta perime, me shumice dhe me pakice
- Autoservis si dhe tregetim makineri, makinab te ndryshme e pjese kembimi per to.

Duke qene se dokumentacioni i paraqitur ploteson kushtet ligjore per te regjistruar shoqerine tregetare "ELVISI 03" shpk si person juridik

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te Ligjit nr 7632 dt 04.11.1992, ligjit nr 7638 dt 19.11.1992, ligjit nr 7667 dt 28.01.1993 dhe ligjit nr 7512 dt 10.08.1991

VENDOSA

Regjistrimin si person juridik te shoqerise tregetare "ELVISI 03" SHPK, me ortak te vetem dhe administrator z.Kol GJELOSHI, me kohezgjatje te aktivitetit mbi 10 vjet, me seli ne Fushe KUQE Laç, me kapital themeltar 100 000 leke, dhe me objekt te veprimtarise:

- Perpunim Fraksionim inerte.
- Tregetin me shumice dhe me pakice, import eksport te artikujve / te ndryshem industrial; ushqimor, elektroshtepiake, konfeksione, kozmetike.
- Tregetim dhe shitje produktesh artizanati, kimike, tekstile, artikuj plastik, xhama mobilje.
- Tregetim produktesh te gateshme dhe gjysem te gateshme me shumice dhe me pakice.
- Tregetim te artikujve sportive dhe argetimi, materjale kancelarie, paisje zyresh etj. Aktivitete te ndryshme tregetare si hapje dyqane, bar bufe, hoteleri, restorante..
- Tregetim materjale ndertimi, paisje te ndryshme elektrike e me shumice dhe me pakice si dhe import eksportin e tyre.
- Investime ne ndertim e fusha te tjera.
- Transport, import, eksport dhe tregetimin e produkteve bujqesore e blegtorale, fruta perime, me shumice dhe me pakice.
- Autoservis si dhe tregetim makineri, makina te ndryshme e pjese kembimi per to.

Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

G J Y Q T A R E

Abdullah Baj

Osman

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE

Nr. _____ Vendimit

28 825/1

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 18.07.03 une Gjyqtare e Gjykates se shkalles se pare Tirane

Ab. Vllas mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesit:
- Kol Gjeloshi

per depozitim prane regjistrimit tregtar te gjykates te shkalles se pare Tirane te vendimit te ortakut te vetem te shoqerise tregtare "ELVISI 03" sh.p.k. dhe :

KONSTATOVA

Se me vendimin Nr.28925 dt.27.01.2003 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "ELVISI 03" sh.p.k. me ortak te vetem dhe administrator z.Kol Gjeloshi.

Me vendimin Nr.1 dt.17.07.2003 te ortakut te vetem te shoqerise tregtare "ELVISI 03" sh.p.k. eshte vendosur te shtohet nje ortak ne kete shoqeri z. Dashmir Ymeraj duke ju shitur kuota e kapitalit ne masen 50% si dhe emerimi si administrator i shoqerise i z. Dashmir Ymeraj.

Kerkesa eshte e drejte dhe duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 dhe te Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993:


V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitim prane regjistrimit tregtar te vendimit te ortakut te vetem te shoqerise tregtare "ELVISI 03" sh.p.k. ku eshte vendosur te shtohet nje ortak ne kete shoqeri, z. Dashmir Ymeraj duke ju shitur kuota e kapitalit ne masen 50% si dhe emerimi si administrator i shoqerise i z. Dashmir Ymeraj.

Urdherohet zyra e regjistrimit tregtar te beje ndryshimet perkatese ne skeden e shoqerise.

GJYQTARE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE

Nr. 28925/2

V E N D I M
“ I G J Y Q T A R I T T E V E T E M “

Une gjyqtarja e vetme, **Blerina Muça**, ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane, sot ne datën 06.04 2003 mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga z. **Dashmir Ymeraj** per depozitimën e **Vendimit Nr. 2** date **10.03.2005** te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise “**ELVISI**” Sh.p.k. dhe

K O N S T A T O V A :

Me **Vendimin Nr. 28925** date **27.01.2003** eshte rregjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “**ELVISI**” Sh.p.k., me kapital themeltar te Shoqerise **100.000** leke, me dy ortakë Kol Gjeloşi dhe Dashmir Ymeraj dhe administrator z. Dashmir Ymeraj.

Me vendimin Nr.82 date 22.02.2005 te Gjykates se Shkalles se Pare Kurbin eshte leshuar deshmia e trashegimise ligjore per trashegimlensesin Kol Gjeloşi duke percaktuar si trashegimtare ligjore te radhes se pare te tij bashkeshorten Marjana Gjeloşi dhe femijet Rajmonda Gjeloşi, Mira Gjeloşi, dhe Klevis Gjeloşi te cilët trashegojne ne menyre te barabarte nga $\frac{1}{4}$ pjese e pasurise se trashegimlensesit Kol Gjeloşi.

Me **Vendimin Nr. 2** te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise date **10.03.2005** eshte vendosur te behen keto ndryshime :

Depozitimi i vendimit Nr.82 date 22.02.2005 i deshmise se trashegimise ligjore.

Depozitimi i kontrates se shitjes se kuotave te kapitalit nga ortakët Rajmonda Gjeloşi, Mira Gjeloşi, dhe Klevis Gjeloşi te cilat disponojne nga 12.2% te kuotave te kapitalit te shoqerise tek ortakja tjeter e shoqerise Marjana Gjeloşi, e cila behet me 50% te kuotave te kapitalit te shoqerise.

Te ruaje te pandryshuara te gjitha dispozitat e tjera te paraqitura ne Statutin e Shoqerise.

Kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne ligje dhe si e tille duhet pranuar .

PER KETO ARESYE

Ne baze te ligjit Nr. 7512 date 10.08.1991 ,Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 , Ligjit Nr. 7667.date 28.01.1993 “ Per Regjistrin tregetar “.

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses.

Depozitimën prane regjistrin tregetar te vendimit Nr.82 date 22.02.2005 te Gjykates se Rrethit Gjyqsor Kurbin me te cilin eshte çelur deshmia e trashegimise ligjore per trashegimlensesin Kol Gjeloşi duke percaktuar si trashegimtare ligjore te radhes se pare te tij bashkeshorten Marjana Gjeloşi dhe femijet Rajmonda Gjeloşi, Mira Gjeloşi, dhe Klevis Gjeloşi.


Depozitimën prane regjistrin tregetar te **Vendimit Nr. 2** date **10.03.2005** te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise “**ELVISI**” Sh.p.k.

Depozitimën e Kontrates se Shitjes se Kuotave me Nr. 121 Rep. date 17.03.2005, te noterit **Nezir Murati**.

Te ruaje te pandryshuara te gjitha dispozitat e tjera te paraqitura ne Statutin e Shoqerise.

Te ndahen regjistrimet nga njeri - tjetri me vije te kuqe , dhe te behen ndryshimet perkatese ne kollonat 4 dhe 5 .

G J Y Q T A R E
Blerina Muça



06.04.05



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
KURBIN**

**Nr. rregj.them.146
Date.08.02.2005**

**Nr. 82 vendimi
Date .22.02.2005**

**VENDIM
« NE EMER TE REPUBLIKES »**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbini e përbëre nga :

Enton Dhimitri - GJYQTAR

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Davida Jushi**, sot me dt.22.02.2005, perfundoi se shqyrtuara ne seance gjyqësore publike çeshtjen civile me Nr.146 regj.them. qe i perket :

K E R K U E S : Marjana Gjeloşi , e bija e Rrokut dhe e Lukes e dtl.07.05.1973, lindur ne Shkoder e banuese ne Fush Kuqe , e ve , me arsim te mesem, me shtetsi e kombesi Shqiptare, perfaqesuar ne gjykim me deklarim ne seance nga av. Pal Metaj.

O B J E K T I : Leshimin e deshmise se trashegimise ligjore .

BAZA LIGJORE : Neni 348,360 e vijues i Kodit Civil, neni 388 I K.pr.Civile.

Gjykata pasi degjoi shpjegimet e e kerkueses rreth faktit objekt Gjykimi ,mori provat e paraqitura prej saj,gjate shqyrtimit gjyqësor ne perfundim te te cilit , ajo kerkoi pranimin e kerkeses.

VEREN

Se kerkuesja i eshte drejtuar Gjykates me kerkese per leshimin e deshmise se trashegimise per te ndjerin Kol Gjeloşi

Gjykata çmon se kerkuesja ka interes per nje kerkim te tille , si ish bashkeshortja e te ndjerit Kol Gjelooshi, e provuar kjo me ane te certifikates se marteses Nr.15-39 date 01.02.2003.

Nga shqyrtimi gjyqsore rezultoi e provuar me ane te certifikates se vdekjes Nr.34-75 date 31.01.2005 se me dt.20.05.2003 ka vdekur Kol Gjelooshi , bashkeshorti i kerkueses.

Ne baze te nenit 318 te K.Civil , ligji qe do te zbatohet per marredhenien e trashegimise ne fjale eshte ligji 7850 date 29.07.1994 "Per Kodin Civil te Republikes se Shqiperise"i cili rezulton te jete ligje ne fuqi ne kohen e vdekjes se trashegimlensit .

Duke iu referuar **nenit 360** te ketij ligji rezultoi e provuar me ane te certifikates se perberjes familjare Nr.15-39 date 31.12.2005 ,certifikates se lindjes Nr.15-39date.31.01.2005 e shtetases Marjana Gjelooshi tashegimtare ligjore te radhes se pare jane:

- Marjana Gjelooshi bashkeshortja
- Rajmonda Gjelooshi e bija
- Mira Gjelooshi e bija
- Klevis Gjelooshi I biri

Te cilet jane qe te gjithe gjalle .

Gjithashtu nga shqyrtimi ne séance gjyqesore nuk rezultoi qe trashegimlensit te kete lene testament , te kete patur femije jashte martese, apo te biresuar,apo ndonjeri prej trashegimtareve te kete hequr dore nga trashegimia ,te jete perjashtuar ose te jete deklaruar I padenje .

Ne keto kushte celet trashegimia ligjore per trashegimlensin Kol Gjelooshi,duke percaktuar si trashegimtare ligjor te radhes se pare ,shtetasit:Marjana Gjelooshi,Rajmonda Gjelooshi,Mira Gjelooshi e Klevis Gjelooshi .

Ne kuptim te **nenit 361** te K.Civil. ato trashegojne 1/4 pjese te pasurise luajtshme dhe te paluajtshme kudo qe ajo ndodhet.


Persa dhe si u arsyetua me siper Gjykata çmon se kerkesa eshte e bazuar ne prova e ne ligje dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne nenin 348,360 e vijues te K.Civil. dhe 388 te K.Pr.Civile.

VENDOSI

Pranimin e kerkeses se kerkueses.





Leshimin e deshmise se trashegimise ligjore per te ndjerin Kol Gjeloshi, duke percaktuar si trashegimtar ligjor te radhes se pare shtetasit:

- Marjana Gjeloshi
- Rajmonda Gjeloshi
- Mira Gjeloshi
- Klevis Gjeloshi

te cilet trashegojne 1/4 pjese secili,te pasurise se luajtshme e te palujtshme kudo qe ajo ndodhet.

Trashegimtarët do te pergjigjen per detyrimet ne perputhje me pjesen e pasurise se trasheguar dhe brenda kufirit te kesaj pasurie

Shpenzimet gjyqesore I ngarkohen pales kerkuese.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 diteve nga e nesermja e shpalljes se tij.

U shpall ne Laç, sot me date .22.02.2005.

SEKRETARE

DAVIDA JUSHI



GJYQTARI

ENTON DHIMITRI



V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 25.04 2005 une Gjyqtare e Gjykates se shkalles se pare
Tirane M. Vucica mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi:

- **Dashamir Ymeraj**,
per depozitim prane regjistrimit tregtar te vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise
tregtare " **ELVISI - 03** " sh.p.k. dhe :

KONSTATOVA

Se me vendimin Nr. **28925** dt. 27.01.2003 eshte regjistruar si person juridik
shoqeria tregtare " **ELVISI - 03** " sh.p.k.

Me vendimet Nr. 28925/1 dhe 28925/2, jane bere ndryshime ne kete shoqeri.

Me vendimin Nr. **3**, date 18.04.2005 te asamblese se ortakeve te kesaj shoqerie
eshte vendosur :

- Largimi nga kjo shoqeri i ortakes zj. **Marjana Gjeloshi** duke ju shitur kuota e saj
kapitalit ne masen 50 % e barabarte me 50.000 leke ortakut qe ngelet i vetem ne kete
shoqeri z. **Dashamir Ymeraj**, duke mbetur keshtu shoqeria me ortak te vetem dhe
administrator z. **Dashamir Ymeraj**

Transferimi i kuotave eshte realizuar me kontraten e shitjes Nr.1405 Rep.
date 22.04.2005.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992, dhe te Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993:

V E N D O S A


Pranimin e kerkeses.

Depozitim prane regjistrimit tregtar te vendimit Nr. **3**, date 18.04.2005 te
asamblese se ortakeve te shoqerise tregtare " **ELVISI - 03** " sh.p.k. ku eshte vendosur :

- Largimi nga kjo shoqeri i ortakes zj. **Marjana Gjeloshi** duke ju shitur kuota e saj
kapitalit ne masen 50 % e barabarte me 50.000 leke ortakut qe ngelet i vetem ne kete
shoqeri z. **Dashamir Ymeraj**, duke mbetur keshtu shoqeria me ortak te vetem dhe
administrator z. **Dashamir Ymeraj**

Depozitim e kontrates se shitjes Nr. 1405 Rep. date 22.04.2005.

Urdherohet zyra e regjistrimit tregtar te beje ndryshimet perkatese ne skeden e
shoqerise.

GJYQTARE


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE

Nr. 28925/4 Vendimit

V E N D I M

I G J Y Q T A R I T T E V E T E M

Ne Tirane, sot me daten 08-05- 2007, une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane J. Olovu mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Dashmir YMERAJ, per depozitimim prane regjistrin tregetar te Gjykates te Rrethit Gjyqesor Tirane te Vendimit te ortakut te vetem te shoqerise tregetare "ELVISI-03" shpk dhe:

K O N S T A T O V A:

Se me vendimin Nr.28925, date 27.01.2003 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregetare "ELVISI-03" shpk me ortak te vetem dhe administrator Z.Kole GJELOSHI.

Me vendimin Nr.1, date 17.07.2003 te ortakut te vetem te shoqerise tregetare "ELVISI-03", eshte vendosur te shtohet nje ortak ne kete shoqeri Z. Dashmir YMERAJ, duke i shitur kuota e kapitalit ne masen 50% perqint dhe njeherazi emerimi I ketij te fundit administrator te shoqerise.

Me vendimin Nr.3, date 18.04.2005 te asamblese te ortakeve eshte vendosur largimi nga shoqeria i ortakes Marjana GJELOSHI e cila 50% perqint te kuotave ja ka shitur ortakut tjetër njeherazi administrator i shoqerise Z.Dashmir YMERAJ.

Me Vendimin Nr.4, date 01.03.2007 te ortakut te vetem te shpk "ELVISI-03" Z.Dashmir YMERAJ eshte miratuar shitja e 50% perqint te kuotave per shumen 50.000 leke Z. Ilirjan XHIXHA dhe pranimi i tij ortak ne shpk "ELVISI-03", i cili zoteron 50% perqint te kuotave. Ne ate vendim konfirmohet se administrator i shoqerise "ELVISI-03" do te vazhdoj te jete Z. Dashmir YMERAJ.

Transferimi I kuotave eshte realizuar me kontraten e shitjes Nr.890.Rep, Nr.234/1.Kol., date,24.03.2007.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

P E R K E T O A R S Y E

Ne baze te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 dhe te ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993


V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimim prane regjistrin tregetar te vendimit Nr.4, date 01.03.2007 te ortakut te vetem te shoqerise tregetare "ELVISI-03", ku eshte vendosur pranimi i ortakut Z.Ilirjan XHIXHA, i cili bleu nga ortaku i vetem Z.Dashmir YMERAJ 50% perqint

te kuotave . Nga ky moment shpk "ELVISI-03" ka dy ortak e konkretisht: Z. Dashmir YMERAJ qe zoteron 50% perqint te kuotave, i cili ngelet administrator i shoqerise dhe ortaku tjetër Ilirjan XHIXHA i cili zoteron 50% perqint te kuotave. Depozitimin e kontrates te shitjes me Nr.890.Rep. date,24.03.2007. Urherohet Zyra e regjistrimit tregetar te beje ndryshimet perkatese ne skeden e shoqerise.

GJYQTARE

A handwritten signature in black ink, written over a horizontal line. The signature is cursive and appears to be 'Ilirjan Xhixha'. To the right of the signature, the date '07/14' is written.

URDHER – REGJISTRIMI

1 28925

2 (a) Emertimi: "Elvini 03" s.r.l.

(b) Selia:

(c) Objekti:

(ç) Kapitali:

3. Administrator i shoqerise


Ortakët

4. Statuti është nënshkruar me dt.

5. Regjistruar me dt.

Mandat Arketimi

Gjyqtare

Elvina Ryz


AKT - THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ELVISI 03 " SH P K



Z.Kol GJELOSHI I datelindjes 1961, banues ne Laç , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, si themelues i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar,ne te cilen eshte ortak I vetem dhe administrator, sot me date 10.01.2002, vendosi te hartoje kete akt themelimi, mbeshtetur ne parimet e meposhtme :

NENI 1

Themeluesi me anen e ketij akti themelimi dhe statuti krijon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te cilen do ta emertoje "ELVISI 03 " sh.p.k.

NENI 2

Selia e shoqerise do te jete ne Fushe KUQE Laç .

Me vendim te ortakut te vetem mund te ndryshohet selia e shoqerise, si dhe hapen filjale te saj ose forma te tjera te shoqerise, ashtu si kunder do ta shohe te nevojshme shoqeria, brenda dhe jashte teritorit te Shqiperise.

NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje kohe te pacaktuar por sidoqofte mbi 10 vjet dhe ky afat do te filloje nga momenti i regjistrimit te saj ne regjistrin tregetar.Afati i kohezgjatjes se shoqerise mund te ndryshoje sipas parashikimeve me ligj ose kur vendos ortaku i vetem.

NENI 4

Shoqeria do zhvilloje veprimtarine e saj ne fushen e ;

- Perpunim Fraksionim inerte.
- Tregetin me shumice dhe me pakice , import eksport te artikujve te ndryshem *industrial, ushqimor, konfeksione, kozmetike.*
- Tregetim dhe shitje produktesh artizanati, kimike, tekstile,artikuj plastik,xhama mobilje.
- Tregetim produktesh te gateshme dhe gjysem te gateshme me shumice dhe me pakice.
- Tregetim te artikujve sportive dhe argetimi,materjale kancelarie , paisje zyresh etj.Aktivitete te ndryshme tregetare si hapje dyqane ,bar bufe,hoteleri, restorante..
- Tregetim materjale ndertimi, paisje te ndryshme elektrike e me shumice dhe me pakice si dhe import eksportin e tyre.

- Investime ne ndertim e fusha te tjera .
- Transport ,import, eksport dhe tregetimin e produkteve bujqesore e blegtorale, fruta perime, me shumice dhe me pakice .
- Autoservis si dhe tregetim makineri, makina te ndryshme e pjese kembimi per to.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 100.000 (njeqinda mijë) leke, i zoteruar i gjithi nga ortaku i vetem i shoqerise.

NENI 6

Shoqeria do te rregullohet pervec ketij akti themelimi dhe me norma te percaktuara ne statutin e kesaj shoqerie, i cili do te nenshkruhet nga ortaku i vetem perpara noterit dhe me pas do te miratohet ne Gjykatën e rrethit Tirane ne ditën e legalizimit si person juridik ne Shqiperi.

NENI 7

Ky akt themelimi eshte hartuar ne kater kopje, ne gjuhen shqipe duke patur secila kopje fuqi te njejte ligjore. Nga keto kopje nje mbahet nga noteri, nje kopje depozitohet ne zyren e regjistruarit tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane dhe nje kopje tek zyra e tatimeve.

**THEMELUESI
KOL GJELOSHI**



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. REP NR. KOL


114

VERTETIM


Ne Tirane sot me datën 15.01.2003 para meje noteres Xhevahire BRAHAJ u paraqit personalisht Kol GJELOSHI i datelindjes 1961, banues ne Tirane , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga çertifikata e tij e lindjes , i cili paraqiti dhe nenshkroj para meje aktin e mesiperme, dhe une noterja vertetoj nenshkrimin e tij konforme ligjit.



**NOTERE
XHEVAHIRE BRAHAJ**



S T A T U T I
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ELVISI 03 ”



NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “ELVISI 03” sh.p.k , krijohet ne baze te aktit te themelimit dt.22.11.2002, nga ortaku i vetem Kol GJELOSHI i cili do te ushtroje aktivitetin e saj si person juridik

NENI 2

Shoqeria “ ELVISI 03 ” sh.p. k ushtron veprimtarine e saj ne baze te ligjit 7512 dt.10.08.1991 “Per sanksionimim e mbrojtjen e prones private,nismes se lire,veprimtarise private e te pamvarur e te privatizimit”, te ligjit nr.7638 dt 20.01.1993 “Per regjistrin tregetar”. Kjo shoqeri fiton zotsine per te vepruar me regjistrimin e saj ne regjistrin tregetar te Gjykates se rrethit Tirane.

NENI 3

Emertimi i shoqerise

Emertimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte “ ELVISI 03 ” sh.p.k .Kjo shoqeri e ketij lloji do te perballoje humbjet e saj deri ne vleren e kapitalit te saj themeltar te paraqitur ne kete statut.

NENI 4


Selia e shoqerise

Selia e shoqerise eshte ne Fushe KUQE , Laç .Shoqeria mund te kete filjale dhe perfaqesi te saj edhe ne rrethe te tjera te Republikes se Shqiperise dhe jashte teritorit te saj.

NENI 5

Objekti i Veprimtarise do te jete :

- Perpunim fraksionim inerte .
- Tregetin me shumice dhe me pakice , import eksport te artikujve te ndryshem industrial, ushqimor,elektroshtepiake,konfeksione,kozmetike.
- Tregetim dhe shitje produktesh artizanati, kimike, tekstile,artikuj plastik,xhama mobilje.

- 
- Tregetim produktesh te gateshme dhe gjysem te gateshme me shumice dhe me pakice.
 - Tregetim te artikujve sportive dhe argetimi, materjale kancelarie , paisje zyrash etj. Aktivitete te ndryshme tregetare si hapje dyqane , bar bufe, hoteleri, restorante..
 - Tregetim materjale ndertimi, paisje te ndryshme elektrike e me shumice dhe me pakice si dhe import eksportin e tyre.
 - Investime ne ndertim e fusha te tjera .
 - Transport ,import, eksport dhe tregetimin e produkteve bujqesore e blegtorale, fruta perime, me shumice dhe me pakice
 - Autoservis si dhe tregetim makineri, makina~~sh~~ te ndryshme e pjese kembimi per to.

NENI 6

Kohe zgjatja e shoqerise

Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj mbi 10 vjet .Ajo mund te perfundoje veprimtarine e saj perpara ketij afati ne rastet e prishjes ose te likuidimit te shoqerise te parashikuara keto ne ligjin nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" ne seksionin V te tij.

NENI 7

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte caktuar ne shumen 100 000 njeqint mijë leke, kjo e parashikuar ne nenin 38 te ligjit nr 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", kapital i zoteruar i gjithi nga ortaku i vetem.

NENI 8

Kapitali themeltar eshte lirisht i transferueshem ne rruge trashegimie.

Me vullnetin e ortakut kapitali themeltar mund te transferohet edhe personave te trete.

NENI 9

Ortaku, i cili eshte themelues i kesaj shoqerie me vullnetin e tij mund te shtoje kapitalin themeltar te shoqerise ne çdo perjudhe qe ai e sheh te nevojshme.

NENI 10

Administrator i shoqerise eshte Kole GJELOSHI .

NENI 11

Ortaku i vetem ka te drejte :

- Te emeroje dhe te shkarkoje personelin administrativ te shoqerise.
- Te informohet ne çdo kohe per veprimtarine e shoqerise dhe te njihet me llogarite dhe dokumentacionin e saj
- Percakton te drejtat dhe detyrat e personelit te shoqerise.
- Ben ndryshime te nevojshme ne statut, ne interes te mbarevajtjes se veprimtarise ekonomike e administrative te shoqerise.
- Te kryej çdo veprim qe e çmon te arsyeshem dhe konforme ligjit.
- Shkrin ndryshon ose mbyll veprimtarine e shoqerise.
- Te jape urdhera dhe udhezime personelit te shoqerise dhe te vendose sanksione ndaj tyre ne perputhje me kontratat e punes.
- Te angazhoje shoqerine ne marredhenje me te tretet ne perputhje me veprimeve qe jane ne perputhje me dispozitat ne fuqi, brenda nevojës dhe organikes se percaktuar.
- Te punesoje persona fizik (vendas dhe te huaj) sipas specialiteteve me afat ditor, javor,sezonal apo vjetor;

kontabel te autorizuar i cili ben bilancin e vitit ushtrimor paraardhes dhe te ardhurat, fitimet dhe humbjet,te formuluar keto konforme ligjit .

- Te lidhe kontrata pune me persona fizik apo shoqeri te tjera private e shteterore, vendase apo te huaj.
- Ben ndryshime ne objektin e veprimtarise se shoqerise.

NENI 12

Administratori i shoqerise ka per detyre:

- Te punoje, te drejtoje e te organizoje ne menyre te tille qe te siguroje suksesin e shoqerise ne veprimtarine e saj ekonomike financiare;

- Te zbatoje vendimet e marra nga ortakut i vetem dhe urdherat e marra prej tij, te dhena brenda kompetencave te percaktuara nga statuti i shoqerise dhe legjislacioni ne fuqi.
- Te paraqese ne menyre te rregullt raportin e administratorit, te inventarit, bilancit dhe te llogariver vjetore, ortakut brenda nje afati gjashte mujor pas mbylljes se vitit financiar paraardhes.
-

NENI 13

Per perfaqesimin e shoqerise perpara organeve shteterore administrative dhe gjyqesore ose te treteve, shoqeria prezantohet nga ortakut i vetem i saj dhe administratori.

NENI 14

Shoqeria ka vulen e vet. Forma dhe teksti percaktohen nga ortakut i vetem.

NENI 15

Bilanci dhe te ardhurat

Veprimet ekonomike dhe financiare fillojne me 1 Janar dhe mbyllen me 31 Dhjetor te çdo viti. Ortaku i vetem cakton nje ekspert te autorizuar i cili ben bilancin e vitit ushtrimor paraardhes me te ardhurat, fitimet dhe humbjet, te formuluar keto konforme ligjit nr. 7661 dt. 19.11.1993 " Per kontabilitetin " Bilanci miratohet nga ortakut i vetem i shoqerise. Ai depozitohet ne zyren tatimore sipas afatit ligjor.

NENI 16

Eshte kompetence e ortakut te vetem te vendose per krijimin e fondeve nga te ardhurat neto si dhe perdorimin e tyre sipas nevojave te tij, shume e cila duhet te jete sa 1/20 e te ardhurave neto te saj per *forumin*
Kesherri e dardanis

NENI 17

Kapitali i shoqerise depozitohet ne llogarine e shoqerise prane nje banke private ose shteterore vendase ose te huaj qe vepron ne territorin e Shqiperise. Shoqeria mund te çele llogari bankare ne leke ose ne valute ne

nje banke tjeter private apo shteterore vendase ose te huaj, brenda dhe jashte vendit.

NENI 18

Fitimi neto qe do te realizohet nga veprimtaria e kesaj shoqerie i perket teresisht ortakut te vetem te saj. Per detyrimet qe do te krijohen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te kesaj shoqerie, kjo shoqeri pergjigjet me kapitalin e saj.

NENI 19

Shperberja

Duke qene se ne çdo kohe per motive te ndryshme shoqeria mund te ndodhet perballe shperberjes, me vendim te ortakut te vetem vendoset per menyren e likujdimit te saj, ne baze te ligjeve ne fuqi.

Likujdimi i shoqerise mund te behet sipas rasteve te parashikuara ne ligjin nr 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare "..

NENI 20

Per çeshtje qe nuk parashikohen e rregullohen nga ky statut, vlejne dispozitat e ligjit nr, 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare ", seksioni per shoqerite me pergjegjesi te kufizuar si dhe aktet e tjera ligjore qe rregullojne kete veprimtari.

NENI 21

Shoqeria do te kete vulen e saj, forma dhe teksti do te percaktohen nga ortaku i vetem i shoqerise.

Statuti u perpilua ne kater kopje me fuqi te njejte ligjore te cilat do te sherbejne per tu administruar ne organet kompetente tatimore dhe gjyqesore dhe kopjet e tjera mbeten ne dokumentacionin baze te shoqerise.

**ORTAK DHE ADMINISTRATOR
KOLE GJELOSHI**




REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR REP NR KOL

114

VERTETIM

Ne Tirane sot me date 15.01.2003 ne zyren e noterise Tirane, para meje noteres u paraqit personalisht Kol GJELOSHI i datelindjes 1961, banues Lac madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar per identitetin e te cilit u sigurova nga dokumentat e tij personale certifikate lindjes ,i cili paraqiti dhe nenshkroj para meje statutin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " ELVISI 03 " sh.p.k. Une noterja vertetetoj nenshkrimin e saj konforme ligjit.

**NOTERE
XHEVAHIRE BRAHAJ**



KERKESE

3 E. Bexho
16 01 2003
[Signature]

KERKUESI : Kole GJELOSHI , i datelindjes 1961, me banim ne Fushe Kuqe LAC .

OBJEKTI: Regjistrim si person juridik te shoqerise " ELVISI 03 "


Baza ligjore : Ligji nr 7632 dt 04.11.1992, ligjit nr 7638 dt 09.11.1992, ligji nr 7667 dt 28.01.1993 dhe ligji nr 7512 dt 10.08.1991.

28925

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE

Une kerkuesi jam me banim ne Tirane. Me aktin e themelimit te lates 10.01.03, kam themeluar si ortak i vetem dhe administrator hoqerine me pergjegjesi te kufizuar " ELVISI 03 " sh.p.k, "me objekt te eprintarise sipas statutit bashkengjitur , me kohe me seli ne Fushe KUQE , me kapital themeltar 100.000 leke, zgjatje te aktivitetit mbi 10 jet .

